



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 11.02.2020

Ref: 148/20D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), nenin 108 të Ligjit mbi procedurën administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016) Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KShC), mori:

V E N D I M

Për korrjigjimin (përmirësim) e vendimit Nr. 451/18D, datë 18.05.2018 të Kolegjit Pjetër Budi

Korrigjohet (ndryshohet) vendimi i KShC-së Nr. 451/18D, datë 18.05.2018 të Kolegjit Pjetër Budi në pikën II të vendimit

- I. Korrigjohet (ndryshohet) pika II e vendimit të KShC-së Nr. 451/18D, datë 18.05.2018, në të cilën përmirësohet zgjatja e periudhës së akreditimit deri më 30 Shtator 2022 për programin e studimit:
 1. Menaxhment (MA), 120 ECTS, me specializim në: Menaxhimi i Turizmit dhe Hotelerisë, 2. Menaxhimi i Sigurimeve, 3. Menaxhment
- II. Pjesa tjetër e vendimit të KShC-së Nr. 451/18D, 18.05.2018, mbetet e pa ndryshuar.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Kolegji Pjetër Budit ka parashtruar kërkesë për përmirësim të vendimit të KSHC-së Nr. 451/18D, datë 18.05.2018, në pikën dy. Pas dëshmive të ofruara dhe verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, ka konstatuar se gjatë vendimit për zgjatje të akreditimit nr 451/18D, në vend se të bëhet zgjatja e akreditimit të programit Menaxhment MA 120 ECTS deri më 30 Shtator 2022, AKA ka vendosur gabimisht si zgjatje periudhën 30 Shtator 2019. Prandaj përmes këtij vendimi, mbi bazën e dëshmive të ofruara, AKA vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Pjetër Budi;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



G. Luboteni

Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë